

### 3 ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË VEND

(16) Ekonomia shqiptare përshpejtoi ritmin vjetor të rritjes së saj, në 3.94%, në tremujorin e parë të vitit. Në rritjen ekonomike kontribuan sektorët e shërbimeve, të prodhimit dhe të bujqësisë, dhe spikatën degët e tregtisë, ndërtimit, transportit dhe industrisë. Rritja e kërkesës agregate u mbështet nga zgjerimi i konsumit final të popullatës (me peshën kryesore), rritja e konsumit të qeverisë dhe formimi i kapitalit fiks. Gjithashtu, në zgjerimin e kërkesës ka kontribuar pozitivisht edhe ngushtimi i deficitit të llogarisë korrente në bilancin e pagesave, kryesisht si rrjedhojë e zgjerimit të tepricës pozitive në llogarinë e shërbimeve. Zhvillime pozitive regjistron edhe tregu i punës, ku norma e papunësisë shënoi nivelin 14.2%<sup>6</sup>. Për pjesën e mbetur të vitit, pritshmëritë mbi nivelet e punësimit mbeten pozitive për të gjithë sektorët e ekonomisë.

(17) Në vijim të presioneve të përmbajtura të inflacionit, politika monetare ka mbetur lehtësuese për të nxitur zgjerimin e aktivitetit ekonomik, gjatë periudhës. Kushtet monetare stimuluese kanë mbështetur ecurinë e kreditimit, duke ndikuar në gjallërimin e konsumit dhe të investimeve private. Në këtë mënyrë është synuar të ndikohet kthimi gradual i normës së inflacionit pranë nivelit të objektivit. Në qershor 2017, inflacioni vjetor arriti në nivelin 2.2%, me rritje ndaj të njëjtës periudhë të vitit të kaluar<sup>7</sup>. Qëndrueshmëria e inflacionit u ndikua kryesisht nga përmirësimi i aktivitetit ekonomik dhe prirja rritëse e çmimeve në tregjet botërore. Banka e Shqipërisë pret që efekti i këtyre faktorëve të shtrihet edhe në periudhat në vijim, duke bërë që vlerat e inflacionit të lëvizin drejt nivelit objektiv prej 3% në afatin e mesëm.

(18) Procesi i konsolidimit fiskal shfaq një ritëm më të ulët gjatë periudhës. Në fund të periudhës, teprica buxhetore ishte pozitive për rreth 3.1 miliardë lekë, kundrejt vlerës prej 17.2 miliardë lekësh një vit më parë. Në tkurrjen e suficitit buxhetor ndikoi rritja e shpenzimeve buxhetore me ritëm më të lartë se rritja e të ardhurave<sup>8</sup>. Me gjithë impulsin pozitiv që ka dhënë tkurrja e suficitit buxhetor në afat të shkurtër në rritjen ekonomike, procesi i konsolidimit fiskal është i nevojshëm të vijojë për të siguruar qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike në afat më të gjatë. Me rëndësi në këtë proces është planifikimi sa më i mirë i zërave kryesorë të buxhetit dhe përmirësimi i shkallës së realizimit të shpenzimeve kapitale.

<sup>6</sup> Norma e papunësisë shënonte nivelin prej 16.6% në T1 2016, ndërsa mbetet thuajse në të njëjtin nivel më dhjetor 2016: 14.17%.

<sup>7</sup> Më konkretisht, në dhjetor 2016, kjo normë shënoi vlerën 2.2% përkundër vlerës 1.2% në qershor të 2016-ës.

<sup>8</sup> Të ardhurat vjetore shënuan një vlerë kumulative prej 212.2 miliardë lekësh (7.0% rritje vjetore), ndërsa shpenzimet e përgjithshme shënuan vlerën 209.2 miliardë lekë (15.5% rritje vjetore).



(19) Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi pozitiv, me zgjerim të mjeteve valutore (rezervës) gjatë tremujorit të parë të vitit 2017. Në fund të këtij tremujori, deficit i llogarisë korrente në bilancin e pagesave u ul ndjeshëm, duke u tkurrur me 20% në terma vjetorë, në vlerën 179 milionë euro. Në këtë ecuri, ndikuan përmirësimi i tepricës pozitive në llogarinë e shërbimeve<sup>9</sup> dhe zgjerimi më i ngadaltë i deficitit tregtar në mallra për shkak të rritjes më të shpejtë të eksporteve<sup>10</sup>. Flukset hyrëse në llogarinë e të ardhurave dytësore nuk kishin ndryshime thelbësore kundrejt një viti më parë<sup>11</sup>. Brenda kësaj kategorie, dërgesat e emigrantëve zënë rreth 80% të totalit dhe vlerësohet të kenë sjellë prurje valutore në nivelin prej rreth 137 milionë eurosh. Ngushtimi i deficitit tregtar në mallrave i dedikohet: (i) rritjes së eksportit të produkteve minerale në zërin “Xeherorët, zgjyrat dhe hiri” dhe (ii) rritjes së eksporteve në zërin “Metale bazë dhe artikujt prej tyre (giza dhe çeliku)”. Fluksi i detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën vlerësohet 272 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej rreth 2%. Detyrimet financiare u krijuan në masën më të madhe nga investimet e huaja direkte hyrëse, të cilat rezultuan 168 milionë euro, duke qenë rreth 8% më të larta se një vit më parë. Kontributin kryesor në rritjen e investimeve të huaja direkte hyrëse vijon ta japë sektori i energjetikës dhe ai i hidrokarbureve. Detyrimet në formën e investimeve të tjera shënuan rritje prej rreth 4% në terma vjetorë ose një zgjerim prej 128 milionë eurosh.

<sup>9</sup> Zgjerimi i suficitit të kësaj llogarie i detyrohet kryesisht rritjes së të ardhurave nga shërbimet e biznesit, të transportit dhe të udhëtimit (bilanci për këtë të fundit, rezultoi 76 milionë euro, 12% më i lartë kundrejt një viti më parë). Teprica pozitive për llogarinë e shërbimeve, rezultoi 274 milionë euro, duke qenë 98 milionë euro më e lartë se e njëjta periudhë një vit më parë.

<sup>10</sup> Kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë, eksportet u rritën me 45%, ndërsa importet u rritën vetëm me 9%, duke shënuar vlerat prej respektivisht 182 dhe 769 milionë euro.

<sup>11</sup> Flukset dytësore arritën në nivelin prej 170 milionë eurosh.

